

**ASAMBLEJA E 3-TE E PERGJITHSHME  
E  
CCI FRANCE ALBANIE**  
(Chambre de Commerce et d'Industrie France Albanie)  
**29 JANAR 2015**

**PROCES VERBAL**

**1. MIRESEARDHJE**

Julien Roche i uroi mirëseardhjen të gjithë pjesëmarrëseve dhe hapi zyrtarisht Asamblenë e Përgjithshme . Ai vuri në dukje pjesëmarrjen e 32 anëtarëve ne mbledhje, pra kuorumi është arritur dhe Asambleja mund te marre vendimet. Ai u uron të gjithëve punime tëmbara.

Kryetari Julien Roche fton Frederic Blanc, Zv. Kryetar i Parë i CCI Francë Albanie për të bërë prezantimin e aktiviteteve të zhvilluara gjatë vitit 2014 dhe projektet që janë parashikuar për 2015-n.

\* \* \*

**ASAMBLEJA E PERGJITHSHME**

**2. RAPORTI VJETOR 2014 DHE PROJEKTET 2015 NGA FREDERIC BLANC, ZV.  
KRYETAR I PARE**

Frédéric Blanc , Zv. Kryetar I Parë I CCI France Albanie prezanton raportin vjetor 2014 dhe projektet që parashikohen të zhvillohen gjatë 2015 (*shih prezantimin bashkangjitur*).

**Gjatë 2014 u zhvilluan:**

- ✓ Asambleja e pergjithshme e CCIFA
- ✓ CCIFA anëtarësohet pranë Forumit të Biznesit frankofon
- ✓ Takime / shkëmbime me personalitete
- ✓ Promovimi i anëtarëve
- ✓ Promovimi i Shqipërisë në Francë
- ✓ Promovimi i aktiviteteve të CCIFA dhe anëtarët e saj nëpërmjet faqes së internetit
- ✓ Projekti më i madh I realizuar : Panairi I Ushqimit dhe Bujqësisë, prill 2014
- ✓ Bashkepunimi me UBIFRANCE

**Projektet gjatë 2015**

- ✓ Të vazhdojë bashkëpunimin me UBIFRANCE

- ✓ Projekt Detar Francë Shqipëri në bashkëpunim me Ambasadën e Francës dhe Ministrive të Bujqësisë të të dy vendeve .
- ✓ CCI jonë mbulon një treg prej mbi 8 milion banorë - Shqipëria Maqedonia Kosova dhe Mali i Zi. (Një pjesë e konsiderueshme e popullsisë së këtyre tre vendeve të fundit është shqiptare dhe nuk ka CCI franceze)
- ✓ Mbrëmje të përbashkët me CCI të tjera bilaterale në Shqipëri. Qëllimi : networku

***Asambleja e Përgjithshme miraton me unanimitet raportin vjetor 2014 dhe projektet për 2015-en***

### **3. NDRYSHIMI I STATUTIT**

Kryetari Roche informon anëtarët që znj. Blerina Kazhani, Sekretare e Përgjithshme e CCI që nga krijimi i saj emërohet me kohë të plotë si Drejtor Ekzekutiv i CCI Francë Albanie.

- Modifikimi i Statutit për të pasqyruar ndryshimin e titullit nga Sekretari i Përgjithshëm në Drejtor Ekzekutiv .

Kryetari informoi anëtarët që UCCIFE ka ndërruar emrin në CCI France a l'international si edhe që Dhoma ka vendosur të ndryshojë emrin dhe logo në harmoni me Unionin e Dhomave, në këtë mënyrë CCI France Albanie do të ketë imazh të njëjtë Dhomat e tjera të Tregtisë në botë

- Modifikimi i Statutit për të pasqyruar ndryshimin e logos së re

***Asambleja e Përgjithshme miraton me unanimitet ndryshimin e titullit nga Sekretar i Përgjithshëm në Drejtor Ekzekutiv dhe logon e re***

### **3. RAPORTI FINANCIAR NGA ZNJ. MIRJETA EMINI , PERGJEGJESE E THESARIT**

Përgjegjsja e Thesarit, znj Mirjeta Emini, së pari paraqiti pasqyrat financiare të 2014, të cilat janë në dosje në formën e raportit financiar dhe bilancit.

*(Shih raportin bashkangjitur)*

Pas prezantimit, Kryetari Roche pyeti anëtarët nëse ka pyetje për raportin financiar. Kërkoj nga Asambleja të miratojë raportin financiar dhe falenderoi Përgjegjësen e Thesarit

***Asambleja e Përgjithshme miraton me unanimitet raportin vjetor 2014***

### **4. Mbyllja e Asamblese nga Julien Roche**

Julien Roche mbyll punimet e Asamblesë së Përgjithshme, falënderoi anëtarët për kohën që ata i kushtojnë CCI Francë Shqipërisë dhe aktivitetet e saj.

Kryetari Roche fton të gjithë pjesëmarrësit në koktejlën e përgatitur për këtë rast dhe të bashkohen mysafirëve të tjerë.

## 5. FJALA E JULIEN ROCHE, KRYETAR I CCI FRANCE ALBANIE

(të gjithë të ftuarit)

**Znj. Ministre,  
Z. Ambasador,  
Të dashur miq,**

Mirëmbrema dhe mirë se erdhët në Asamblenë e 3-te të Dhomes tone te Tregtise France Shqiperi

Që nga krijimi i saj, kam nderin dhe kënaqësinë, bashkë me ndihmen e cmuar te anëtarëve te Këshillit Drejtues, t'i shërbej CCI Francë-Shqipëri me te cilen jemi te gjithë shume te lidhur.

Falenderoj shumë anëtarët tanë si franceze dhe shqiptare për pjesëmarrjen e tyre aktive. Ne jemi tashmë një organizatë me 53 anëtarë në Shqipëri dhe Francë. Gjithashtu është mirë të përmëdim që jemi një Dhomë private, e cila vetë-financohet, pa ndihme publike.

Qëllimi ynë kryesor është të ndihmojmë dhe të shoqërojmë të gjitha kompanitë të cilat dëshirojnë të investojnë në Shqipëri duke ofruar shërbimet e përshtatshme per ta. Ne jemi gjithashtu një mjet influence pranë pushtetit publik lokal dhe pranë aktorëve ekonomike ne vend. Sigurisht qe jemi edhe ne dispozicion te kompanive shqiptare te cilat deshirojne te zhvillohen ne tregun francez.

Ne përhapim emrin e Francës kudo në Shqipëri.

Viti 2014 ishte për Dhomen tonë viti i ndërmarrjes së projekteve të reja.

- Se pari, organizimi i Panairit Bujqësor i cili u zhvillua më 25 dhe 26 Prill 2014. Panairi priti 41 ekspozues nga 5 shtete dhe 3000-4000 vizitorë gjatë dy diteve.
- Ndryshimi i emrit dhe logos. Ashtu sikurse emërtimi i "UCCIFE" është kthyer në 'CCI France a l'International', gjithashtu edhe ne adaptuam emrin dhe logon e re, me qëllim qe Dhoma te kete imazh të përbashkët në botë.
- Fluturime direkte Paris Tirane duke filluar më 31 Mars 2015
- Krijimi i Guides Praktike per exportuesit, si edhe materiali "Informacion mbi Shqipërinë"
- Bashkepunim me UBIFRANCE (Bussiness France)
- CCI është bërë anëtare e Forumit Frankofon të Biznesit

Në ditët e sotme, network-u është faktor kyc në suksesin e kompanive. Ndarja e informacionit është shumë e rëndësishme.

Për këtë qëllim, dhoma jonë ka krijuar në faqen tonë zyrtare në internet, një hapësirë vetëm për ju.

Në këtë rubrikë shfaqen aktualitetet tuaja që ju deshironi te publikoni. Një rrjet me më shumë se 4000 kontakte, ku përfshihen anëtarë dhe partnerë të shumtë, do të informohen mbi aktivitetet tuaja.

Projekte të tjera janë në studim e sipër te cilat do te vihen në jetë gjatë 2015-ës.

Këto rezultate janë arritur falë ndihmës së bashkëpunëtorëve dhe Këshillit Drejtues. Ju falenderoj të gjithëve pasi pa këtë angazhim, ne nuk mund t'ju shërbejmë anëtarëve tanë. Falenderoj edhe Rogner Hotel, anëtar me I ri i CCI i cili na ka pritur sonte në ambjentet e tij

Falenderoj gjithashtu Societe Generale Albania e cila ofron zyrën për Dhomen tonë.

Angazhime të mëdha profesionale e detyrojnë mikun tonë Gasmen Toska të largohet nga Keshilli Drejtues I Dhomes. Ai mbetet nje anetar aktiv I Dhomes tone dhe e falenderoj personalisht per te gjitha kontributet e tij.

Ju faleminderit,